VIOLETA SHAMKU

MUZIKA

LIBËR MËSUESI

Klasa III

BOTIME

pegi

BOTIME

Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9928-248-11-4

© Botime Pegi, korrik 2017
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

Hyrje **5**
Çfarë synon ky libër? 6
Çfarë përmban ky libër? 6

Kompetencat dhe kuptimi i tyre 7
Lidhja e muzikës me *kompetencat kyçe* 9
Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare 11

Planifikimi i kurrikulës - kuptimi dhe zbatimi 12
Planifikimi vjetor - "Muzikë" 13
Planifikimi sipas 3 periudhave (i ndërthurur) 14, 43, 73
Planifikimi ditor 19, 49, 78

Vlerësimi
Llojet e vlerësimit në klasën e tretë/shkallën e dytë (arsimi fillor). 94

1. Hyrje

I dashur koleg!

Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit/et të kuptojnë dhe të lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit të tyre, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimit të muzikës.

Lënda e muzikës synon të edukojë dhe formojë nxënësit/et nga pikëpamja muzikore, duke i orientuar ata krijimtari drejt kuptimit të veçorive të ligjërimit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, drejt formimit, ndërtimit të një gjykimi, vlerësimi dhe qëndrimi artistik në njohjen me veprat muzikore.

Nxënësi/ja tashmë e ka filluar rrugëtimin e tij në muzikë përmes njohjes me dy elementet bazë ***ritmin*** dhe ***melodinë***. Ritmin e kanë zbuluar dhe gjetur në mjedisin përreth dhe më pas në muzikë, kanë përjetuar duke provuar modele të ndryshme ritmike dhe kanë krijuar ritme me dy, tri dhe katër goditje. Tingujt i kanë zbuluar në mjedisin përreth dhe kanë filluar të përcaktojnë dhe karakteristikat e tyre, duke u shprehur me fjalë të thjeshta.

Këngët dhe lojërat didaktike për fëmijë, apo dhe këngët-lojë popullore, të përshtatshme për nga karakteri, përmbajtja e shtrirja e vokalit (zërit), me dhe pa shoqërim instrumental, mësohen duke formuar një kulturë vokale, përmes ***teknikave*** të kënduarit dhe ***procesit*** të këndimit. Luajtja me instrumentet me goditje dhe shoqërimi i këngëve dhe i lojërave muzikore është një tjetër veprimtari që njohin dhe kryejnë nxënësit/et. Krijimi i modeleve ritmike përmes ligjërimit të vargjeve, shoqërimit me lëvizje trupore, me shuplaka, janë veprimtari që zhvillohen në këtë nivel moshe dhe intelekti të fëmijëve.

Zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve/eve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'ju shërbejë mësuesve/eve të muzikës, si një ***udhërrëfyes***, ku ata/ato do të demonstrojnë aftësitë e tyre mësimdhënëse dhe profesionale në lëndën e muzikës, për zbatimin më së miri të risive dhe të qasjes së re të kurrikulës me kompetenca.

Çfarë synon ky libër?

Mësimdhënia bazuar në ***kompetenca***, e trajtuar përmes këtij libri, do të shërbejë si për të gjithë mësuesit/et e muzikës, të ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arsimit fillor, programet mësimore* dhe të vlerësimit bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në klasën e tretë,* të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit;

b) metodologjinë e mësimdhënies;

c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e tretë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së muzikës, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe atyre kyçe, për të planifikuar dhe për të realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës/e të kësaj lënde, në përshtatje me dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së dytë, të shkallës së parë të lëndës *Muzikë*, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014 dhe merr përsipër:

– ***të sqarojë*** të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues/e që jep mësim në klasën e tretë;

– ***të paraqesë dokumentet*** e hartuara dhe ***mënyrën se si ato*** duhet të përdoren nga mësuesi/ja në lëndën e muzikës;

– të udhëzojë ***formatet*** e reja: plani vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit etj., me të cilat mësuesi/ja duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ndryshe nga çka mësuesi/ja është mësuar të gjejë në një libër mësuesi, ky libër jep në parim dhe ofron ose sugjeron modele, por ***nuk i dikton*** ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit dhe metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORJA

2. PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Programi mësimor zhvillon përmbajtje të caktuara mësimore/muzikore që i përgjigjen moshës dhe nivelit intelektual të nxënësve/eve të kësaj klase dhe qëllimit që ka lënda. Gjithashtu, ky program krijon kushte për ndërtimin e ***kompetencave të lëndës*** së ***muzikës*** si dhe të ***kompetencave kyçe***, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën; realizimin e ***temave ndërkurrikulare*** apo ***lidhjes së muzikës me fushat e tjera kurrikulare,*** të cilat janë gjithashtu komponentë të rëndësishëm për kontributin e muzikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të edukimit dhe formimit të nxënësve/eve. Muzika e klasës së tretë bën pjesë në ***shkallën e dytë***.

1.1. Kompetencat kyçe dhe muzika

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. kompetenca e të menduarit;
3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. kompetenca personale;
6. kompetenca qytetare;
7. kompetenca digjitale.

Diagrami 1: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës, për shkallën e dytë.

SHKALLA E DYTË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
• Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike. • Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohen. • Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike. • Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.
Kompetenca e të menduarit
• Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit. • Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi. • Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese. • Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
• Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor. • Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor. • Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
• Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.
Kompetenca personale
• Zhvillon besimin te vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor, respekton punën e vet dhe të të tjerëve. • Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.
Kompetenca qytetare
• Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
Kompetenca digjitale
• Përdor mjetet: magnetofon, video CD, DVD, kompjuter etj.

1.2. Kompetencat dhe tematikat në lëndën e muzikës:

a) *kompetencat lëndore muzikore*;

b) *tematikat,* që përfaqësojnë përmbajtjen muzikore përgjatë klasës së tretë.

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në çdo fushë të nxëni në gjithë arsimin fillor. Ato zhvillohen dhe ndërtohen përmes kompetencave **të krijimit, të interpretimit dhe të vlerësimit**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre. Kompetencat lëndore të muzikës lidhen dhe plotësojnë dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike **kompetencat kyçe.** Zotërimi i muzikës nënkupton ***zotërimin e kompetencave muzikore***, që do të thotë aftësia për të krijuar, për të interpretuar një këngë apo lojë muzikore dhe për të vlerësuar duke gjykuar dhe duke përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh, jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilat muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat renditen si më poshtë:

Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave
Krijimi muzikor	Nxënësi/ja: - përdor ide të ndryshme, duke përdorur elementet dhe gjuhën muzikore; - eksperimenton duke zbuluar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike; - organizon krijimin e vet muzikor, sipas elementeve të gjuhës muzikore; - ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
Performimi/ interpretimi muzikor	Nxënësi/ja: - familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të ndryshme muzikore (këngë/lojëra muzikore, fragmente të thjeshta muzikore); - zbaton teknika dhe procese të ndryshme muzikore gjatë këndimit dhe luajtjes me instrumente; - respekton rregullat e performimit/interpretimit muzikor gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente; - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.
Vlerësimi i veprave muzikore	Nxënësi/ja: - shpjegon me fjalor të thjeshtë këngë/lojëra dhe veprat muzikore të thjeshta.

Tematikat *përmbajtësore,* janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet* dhe *vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe *të kompetencave kyçe*.

Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe i **kompetencave lëndore** që duhet të demonstrojë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse.

Diagrami: Kompetencat *kyçe dhe lëndore,* që formohen përmes *tematikave të muzikës.*

Nëse do të bënim një shpjegim të diagramit, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në

qendër të mësimdhënies (procesit) është nxënësi/ja. Mësuesi/ja duhet të ketë parasysh kompetencat lëndore dhe çfarë rezultatesh

1.3. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, si me kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul si me matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesit/et duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

3. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es, që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor dhe që shoqërohet me përgatitjen e dokumenteve përkatëse.

Koha mësimore sipas tematikave për secilën klasë, Lënda e muzikës, klasa e tretë, zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë në arsimin fillor.

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Orët gjithsej
Klasa e tretë	8	22	5	35 orë

Planifikimi i dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: *liri, fleksibilitet* dhe *përgjegjshmëri në planifikim*. Këto dokumente janë: planifikimi vjetor i lëndës së muzikës, planifikimi sipas periudhave (i ndërthur sipas tematikave) dhe planifikimi ditor.

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me periudha, ku secila periudhë ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim të vitit të ri shkollor. Për shkak të specifikës që ka, lënda e muzikës duhet t'i ndërthurë tematikat dhe njohuritë me njëra-tjetrën, për të mos e bërë monotone orën mësimore dhe lëndën përgjatë:

a) planifikimit vjetor të periudhave;

b) planifikimit vjetor temë për temë.

Periudhat në modelet e mëposhtme janë ndarë, duke bërë një përllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave *me + ose* – që çdo mësues i llogarit vetë.

PLANIFIKIMI VJETOR SIPAS PERIUDHAVE

Planifikimi i temave mësimore bëhet nga vetë mësuesi/ja. Disa këngë apo veprimtari muzikore mund të zgjasin edhe 2 orë. Edhe pse në planin vjetor të mëposhtëm periudhat janë të planifikuara me **x** orë, ju duhet të planifikoni 3 periudhat sipas programit mësimor dhe udhëzimit të MAS të fillim vitit shkollor. Totali i orëve të mëposhtme mund të jetë 33-34, sepse ndonjë temë mësimore parashikohet nga vetë ju të zhvillohet në disa orë. Pra, **liria e planifikimit të planit vjetor ju përket JUVE**.

Tematikat	**Shpërndarja e përmbajtjes lëndore**		
	Shtator – Dhjetor 13 orë	**Janar – Mars 12 orë**	**Prill – Qershor 10 orë**
Gjuha dhe komunikimi muzikor (8 orë)	1. Ritmi me dy goditje – theksi në muzikë dhe fjalë	1. Tingulli shumë i lartë – shumë i ulët	1. Tempi - shpejt/ngadalë, përjetimi muzikor
	2. Gjatësia ritmike – *e gjatë e shkurtër*	2. Tingulli shumë i fortë – shumë i butë	2. Pauza ose pushimi në muzikë
	3. Gjatësia ritmike – *shumë e gjatë dhe shumë e shkurtër*	3. Tingulli shumë i gjatë – shumë i shkurtër	
Teknika dhe procese muzikore (22 orë)	4. Kënga: "Himni Kombëtar"	4. Kënga: "Milingona punëtore"	3. Improvizime ritmike nga melodi popullore
	5. Kënga: "Katër stinët"	5. Glokenshpili – instrumenti Orf	4. Kënga: "Il coccodrillo come fa"
	6. Kënga: "Kam një mik, kam një shok"	6. Kënga: "Mësuesja ime"	5. Kënga: "Cicërimet e zogjve të pyllit"
	7. Kënga: "Lule Velo partizani"	7. Muzika dhe kërcimi – lëvizjet trupore	6. Kënga: "Shqipërisë i ngjaj"
	8. Kënga: "Rrotull pemës po vallëzojmë"	8. Ndërtimi i instrumenteve me goditje	7. Interpretimi më i bukur.
	9. Instrumentet me goditje: *ksilofoni, glokenshpili, metalofoni*	9. Kënga: 'Erdh pranvera"	8. Koncert
		10.Kënga: "Merimanga"	
	10. Krijojmë modele me dy goditje		9. Koncert
	11. Koncert		
Historia, muzika dhe shoqëria (5 orë)	12. Muzika, përjetimi dhe emocioni – muzika e filmit "Beni ecën vetë"	11. Muzika, përjetimi dhe emocioni – fragment nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri)*	10. Emocionet dhe muzika – përjetimi përmes kërcimit dhe fjalës
	13. Muzika, përjetimi dhe emocioni – "Tëinkle, tëinkle litël star"	12. Muzika, përjetimi dhe emocioni – fragment nga muzika e baletit "Petja dhe ujku"	
35 [1] orë			

[1] Planifikimi i temave mësimore bëhet nga vetë mësuesi/ja. Disa këngë apo veprimtari muzikore mund të zgjasin edhe 2 orë.

PLANIFIKIMI[1], PERIUDHA: SHTATOR – DHJETOR

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: 1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike; 2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen; 3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore; 4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë. **Kompetenca e të menduarit** Nxënësi/ja: 1. mendon në mënyrë krijuese; 2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese; 3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese; 4. kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë** Nxënësi/ja: 1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor; 2. përdor burime të gatshme për të realizuar një krijim muzikor; 3. zbaton detyrën e dhënë. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** Nxënësi/ja: 1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës. **Kompetenca personale** Nxënësi/ja: 1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore; 2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve; 3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave. **Kompetenca qytetare** Nxënësi/ja: 1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. **Kompetenca digjitale** Nxënësi/ja: 1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	**Interpretimi muzikor**	**Vlerësimi muzikor**
Nxënësi/ja: • krijon me modele ritmike me dy goditje; • krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe me simbole, duke vënë në pah *theksin e fortë* gjatë ritmizimit të tyre; • krijon, duke përdorur simbole personale mbi ritmin me 2 goditje.	***Nxënësi/ja:*** • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë; • demonstron gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet fëmijërore Orf me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe të melodisë; • luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tri dhe katër goditje; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë, duke iu përshtatur tematikës së këngës; • respekton interpretimin e shokëve/ shoqeve; • respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • shpjegon emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo fragment muzikor gjatë interpretimit.	***Nxënësi/ja:*** • kupton dhe shpjegon dhe bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijohen; • bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; • shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore; • përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; • respekton mendimin e shokëve; • respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; • merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Nr.	Tematika[2]	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Burime dhe materiale
1	*T&P*	Kënga: "Himni Kombëtar"	**Situata: Jam krenar se jam shqiptar** Nxënësit/et nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vet si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
2	*GJ&KM*	Ritmi me dy goditje – theksi në muzikë dhe fjalë	**Situata: Fjala dhe theksi** Shkruhen disa fjalë dy rrokëshe në tabelë dhe u kërkohet nxënësve të ndajnë fjalët, duke shkruar numrat 1-2 dhe thonë me zë të lartë fjalën duke theksuar rrokjen e parë.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
3	*T&P*	Kënga: "Katër stinët"	**Situata: Stina ime e preferuar** Nxiten nxënësit që në 10 minuta të skicojnë stinën e tyre të preferuar dhe të shpjegojnë pse.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit. - teksti i mësuesit.
4	*HM&SH*	Muzika, përjetimi dhe emocioni – muzika e filmit "Beni ecën vetë"	**Situata: Filmi im i preferuar** Vendoset fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë muzikën e filmit "Beni ecën vetë". Pyeten nxënësit a kanë ndonjë film të preferuar? Ata tregojnë arsyet e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
5	*GJ&KM*	Gjatësia ritmike – *e gjatë e shkurtër*	**Situata: Shkurtabiqi dhe gjiganti** Nëpërmjet kësaj loje mjaft të thjeshtë nxënësit nxiten natyrshëm të kuptojnë gjatësinë edhe në muzikë, duke e paraqitur atë nëpërmjet simboleve të ndryshme.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

[2] GJ&KM - Gjuha dhe komunikimi muzikor; T&P - Teknika dhe procese; HM&SH - Historia, muzika dhe shoqëria

6	*T&P*	Këngа: "Kam një mik, kam një shok"	**Situata: "*Miku i mirë me shokë shumë*" - proverb** Shkruhet proverbi në dërrasë apo thuhet me zë të lartë dhe kërkohet nga nxënësit të shpjegojnë kuptimin e saj.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
7	*GJ&KM*	Gjatësia ritmike – *shumë e gjatë dhe shumë e shkurtër*	**Situata: Shkurtabiqët dhe gjigantët** Vazhdohet loja më tej dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë *shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë*.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
8	*HM&SH*	Muzika, përjetimi dhe emocioni – "Twinkle, twinkle little star"	**Situata: Më pëlqen se…** Nxiten nxënësit të flasin rreth përjetimit nga dëgjimi muzikor i një muzike, nga një sjellje e kryer nga shoku, nga vëzhgimi i një vepre arti etj. Pse ne themi se ndihemi mirë ose keq? Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
9	*T&P*	Këngа: "Lule Velo partizani"	**Situata: Dëshmori i qytetit/krahinës time** Nxiten nxënësit të tregojnë historinë/ tregimin e një dëshmori që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
10	*T&P*	Këngа: "Rrotull pemës po vallëzojmë"	**Situata: Festa që më pëlqen më shumë** Nxiten nxënësit të flasin rreth festave që ata festojnë me familjen e tyre dhe festën më të preferuar të tyre. Pse e pëlqejnë festën e Vitit të Ri?	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

11	*T&P*	Instrumente me goditje: Ksilofoni, glokenshpili dhe metalofoni	**Situata: Instrumenti im i preferuar** Vendosen disa foto apo instrumente muzikore në dërrasë të zezë dhe pyeten nxënësit/et a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glokenshpili?	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
12	*GJ&KM*	Krijojmë ritme me 2 goditje	**Situata: Unë dhe ritmi** U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me dy goditje nëpërmjet simboleve, goditjeve me shuplaka apo me instrumenteve me goditje. Shpjegojnë duke ritmizuar modelin e krijuar.	
13	*T&P*	Koncert		- **Cd**

PLANIFIKIMI DITOR – PERIUDHA E PARË

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III

Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Kënga: "Himni Kombëtar"

Situata: Jam krenar se jam shqiptar

Nxënësit/et nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vet si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:

Nxënësi/ja:
- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;
- shpreh emocionet e veta për këngën himn;
- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.

Fjalët kyçe:
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit;
- kënga himn.

Burimet:
- Cd me këngën;
- materiale të parapërgatitura;
- fletorja e nxënësit;
- teksti i mësuesit.

Lidhja me fushat e tjera:
- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.

Lidhja me temat ndërkurrikulare:
- identiteti im.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vet si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë. Më pas nxiten të vizatojnë në shtëpi pamje ose një simbol që përfaqëson Shqipërinë.

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Himni i flamurit" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: Himni i flamurit

- I -

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' me një qëllim,
Të gjith' atij duk' iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frikohet,
Por vdes, por vdes si një dëshmor!

- II -

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,
Këtu armiqtë s'kanë vend.
Se Zoti vet e tha me gojë
Që kombe shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë,
Për të, për të luftojmë ne!

- III -

O flamur, flamur, shenj` e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërin` atdhen` e shtrenjtë,
Për nder` edhe lavdimn` e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jet` ay do të kujtohet
Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimin që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (Shqipëria, kënga himn etj.);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Ritmi me dy goditje – *theksi* në muzikë dhe fjalë		**Situata: Fjala dhe theksi** Shkruhen disa fjalë dy rrokëshe në tabelë dhe u kërkohet nxënësve të ndajnë fjalët, duke shkruar numrat 1-2 dhe thonë me zë të lartë fjalën duke theksuar rrokjen e parë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon burime ritmike që krijohen apo dëgjon në mjedisin përreth; - krijon ritmin me dy goditje; - improvizon modele të ndryshme ritmike me dy goditje.		**Fjalët kyçe:** - ritëm; - dy goditje/rrahje; - model ritmesh me dy goditje.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku shkruhen në tabelë disa fjalë dy rrokëshe dhe u kërkohet nxënësve të ndajnë fjalët, duke shkruar numrat 1-2 dhe thonë me zë të lartë fjalën duke theksuar rrokjen e parë. Në magnetofon mund të dëgjojnë modele ritmike apo fragmente ku luhen ritme të ndryshme të krijuara nga burime apo objekte të ndryshme. Nxënësit/et dëgjojnë dhe i identifikojnë këto ritme me dy goditje, duke i imituar më pas ato dhe theksuar vetëm goditjen e parë.

Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi I: Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të gjejnë në fjalët me dy rrokje të shkruara në tabelë, theksin e fjalës. U kërkohet nxënësve të gjejnë ku bie theksi te fjalët me dy rrokje. Shkruhen fjalë të ndryshme:

shko-lla,	**to - pi,**	**mo - lla.**
1 - 2	**1 - 2**	**1 - 2**

Hapi II: U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes në ushtrimin e zhvilluar nga mësuesi/ja, duke përdorur instrumente me goditje ose mjetet trupore. *Sa goditje dëgjohen?*

Hapi III: Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të plotësojnë fjalët e dhëna në kuicin e krijuar nga mësimdhënësi, por edhe duke vëzhguar figurat.

1. Duke parë figurat dhe materialet e krijuara nga mësuesi/mësuesja, ju kërkohet nxënësit/nxënëses:
- gjejnë dhe imitojnë goditjen që lëshojnë objektet e figurave të mëposhtme.
- përcaktojnë theksin e fortë dhe të butë.

lartë
2
theksi i butë

poshtë
1
theksi i fortë

_____

Vazhdo ti tani...

_____

_____

_____

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (theksi në muzikë dhe në fjalë);
- përcaktimin e theksit në fjalët me dy rrokje e ushtrimin në fjalët me dy rrokje dhe modelet ritmike me dy goditje;
- bashkëpunimin në plotësimin e kuicit të dhënë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "4 stinët"		**Situata: Stina ime e preferuar** Nxiten nxënësit që në 10 minuta të skicojnë stinën e tyre të preferuar dhe të shpjegojnë pse.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për stinët dhe tekstin e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat natyrore: dituria e natyrës.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të skicojnë stinën e tyre të preferuar dhe shpjegojnë pse i pëlqen ajo, duke shprehur emocionet e tyre në 10 minuta.

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "4 stinët" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "4 stinët"

I

Po t'më pyesin mua,
Vjeshtën shum' e dua,
Pemët mbushen plot me moll'
Gjith' fëmijët shkojn' në shkoll'.

Refreni

Dimrin shum' e dua
Ti vjeshtën e zgjodhe,
Dimri ka gështenja,
Por s'ka akullore,
Nuk ka akullore,
Por ka topa bore.

II

Un' dhe shoku im
E duam çdo stin',
Se çdo vit ka katër
Asnjë s'shkon me hatër.
Pranver', verë, vjeshtë, dimër
Katër stinët që ka viti
Shum' i duam ne.

Muzika: Edmond Zhulali
Teksti: Agim Doçi



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (stinët e viti, stina e preferuar etj.);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika, përjetimi dhe emocioni - muzika e filmit "Beni ecën vetë"		**Situata: Filmi im i preferuar** Vendoset fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë muzikën e filmit "Beni ecën vetë". Pyeten nxënësit a kanë ndonjë film të preferuar? Ata tregojnë arsyen e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valse, muzikë filmash* dhe edukohet me përqendrimin në dëgjim; - identifikon karakteristika dhe ndryshime të pjesëve që dëgjon, i dallon dhe i përcakton ato; - reflekton emocionet që i krijon muzika e filmit gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi, - historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor 3-4 minuta, ku nxënësit/et dëgjojnë muzikën e filmit "Beni ecën vetë". Pyeten nxënësit a kanë ndonjë film të preferuar? Ata tregojnë arsyen e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohen fragmente të ndryshme muzikore nga filmi "Beni ecën vetë" dhe filma të tjerë shqiptarë dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. *Pse të pëlqen muzika që dëgjove?*
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse të pëlqen muzika? *Pse të pëlqen të këndosh apo të vallëzosh?*

Duke parë figurat nga filmi “Beni ecën vetë”, mësuesi/mësuesja nxit nxënësit/set të flasin me fjalë të thjeshta mbi emocionet që ndiejnë.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e llojeve të ndryshme muzikore;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Gjatësia ritmike - *tingulli i gjatë - i shkurtër*		**Situata: Shkurtabiqi dhe gjiganti** Nëpërmjet kësaj loje mjaft të thjeshtë, nxënësit nxiten natyrshëm të kuptojnë gjatësinë edhe në muzikë, duke e paraqitur atë nëpërmjet simboleve të ndryshme grafike.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon gjatësinë ritmike që dëgjon apo krijohen në mjedisin përreth dhe muzikë *i gjatë - i shkurtër*; - krijon modele me gjatësi të ndryshme ritmike; - improvizon modele të ndryshme ritmike me dy goditje.		**Fjalët kyçe:** - ritëm; - i gjatë; - i shkurtër; - model ritmesh me dy goditje.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika - gjuha - kërcimi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një lojë mjaft të thjeshtë, ku nxënësit nxiten natyrshëm të kuptojnë gjatësinë edhe në muzikë, duke e paraqitur atë nëpërmjet simboleve të ndryshme grafike. Gjithashtu ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme.

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin, duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të përcaktojnë tingullin që lëshon secili prej tyre.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes, duke kënduar këngën-lojë "Ne jemi dy shqiponja". Në strofën e parë, vendos numrat 1 dhe 2 për çdo rrokje të fjalëve të këngës.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të provojnë të luajnë modelin ritmik të mëposhtëm, duke shoqëruar me rrahjen e duarve.

Duke parë figurat e mëposhtme mësuesi/ja nxit nxënësit të imitojnë dhe shprehin se cila nga figurat krijon tingull të shkurtër dhe cila tingull të gjatë.

tingull i shkurtër

tingull i gjatë

Vazhdo ti tani...

_____

_____

_____

_____

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: gjatësia më e gjatë dhe më e shkurtër;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të ritmit me simbole;
- shoqërimin e shembujve ritmike me shuplaka dhe të regjistrimit grafik të krijuar vetëm ose në grup.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Kam një mik, kam një shok"		**Situata: "*Miku i mirë me shokë shumë*" - proverb** Shkruhet proverbi në dërrasë apo thuhet me zë të lartë dhe kërkohet nga nxënësit të shpjegojnë kuptimin e tij.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha shqipe dhe letërsia; - njohuri për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të flasin rreth proverbit *"Miku i mirë me shokë shumë"*.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Kam një mik, kam një shok" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Kam një mik, kam një shok"

I

Sa shum' kisha dëshir' që të kem një qen,
Po mamit edhe babit s'di si t'ja them,
Un' mendjen e kam mbledhur dhe nuk e zgjas,
Se qenin e kam zgjedhur të jet' dalmat.
Po qenin un' e dua mos t'jet nevrik,
Të jet' një qen i zgjuar edhe besnik.

Refreni

Kërkova në qytet un' an' e mban'
Dhe më në fund e bleva në dyqan,
T'ju them një të vërtet' nuk bëj shaka,
Si qeni im në bot' nuk ka,
La la la la la la la la la….
La la la la la la la la la….

II

Nuk jam un' shum' i bindur jam në dilem
Më mir' të kesh një shok apo një qen,
E di se do të lodhem them seriozisht,
Do t'i mësoj futboll dhe pak anglisht.
Po qenin un' e dua mos t'jet nevrik,
Të jet' një qen i zgjuar edhe besnik.

Refreni

Kërkova në qytet un' an' e mban'……..

N' shëtitje kur un' shkoj me shoqërinë,
Të gjithë i prezantoj me qenin tim,
T'ju them një të vërtet nuk bëj shaka,
Si qeni im në bot' nuk ka.

Muzika: Shpëtim Saraçi
Teksti: Jorgo Papingji



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (shoqëria/miqësia etj.);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Gjatësia ritmike - *shumë i gjatë dhe shumë i shkurtër*		**Situata: Shkurtabiqët dhe gjigantët** Vazhdohet loja më tej dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë *shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë*.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon gjatësinë ritmike që dëgjon apo krijohen në muzikë *shumë i gjatë - shumë i shkurtër*; - krijon modele me gjatësi të ndryshme ritmike të mësuara; - improvizon modele me gjatësi të ndryshme ritmike me dy goditje me gjatësi të ndryshme.		**Fjalët kyçe:** - ritëm; - shumë i gjatë; - shumë i shkurtër; - modele me gjatësi ritmike të ndryshme me dy goditje.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika - gjuha	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi vazhdohet më tej me lojën dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë *shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë*. Gjithashtu, ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të shkruajnë fjalë me *një rrokje, me dy rrokje, me tri rrokje dhe me katër rrokje*. Ata duhet të shënojnë me **(-)** rrahjen më të shkurtër dhe me **(+)** atë më të gjatë.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes, duke vëzhguar tabelën që iu paraqet mësuesi/ja dhe të këndojnë ose ritmizojnë rrokjet. Ata përcaktojnë kush është tingulli *më i gjatë apo më i shkurtër.* Shiko në tabelën e mëposhtme dhe këndoji ose ritmizoji rrokjet.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të shkruajnë emrat e disa objekteve, që lëshojnë tingull *shumë të shkurtër - shumë të gjatë.*

Hapi IV

Më pas u vendoset nxënësve të lexojnë fjalitë dhe plotësojnë fjalët në kutitë bosh në kuicin e paraqitur nga mësuesi/ja.

Duke parë figurat e mëposhtme mësuesi/ja nxit nxënësit të imitojnë dhe shprehin se cili nga figurat krijon tingull shumë të shkurtër dhe cila tingull shumë të gjatë.

Tingull shumë i gjatë

Tingull shumë i shkurtër

Vazhdo ti tani...

_____ _____

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: gjatësia shumë e gjatë dhe shumë e shkurtër;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të ritmit me simbole;
- shoqërimin e shembujve ritmike me shuplaka dhe të regjistrimit grafik të krijuar vetëm ose në grup.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika, përjetimi dhe emocioni - "Twinkle, twinkle little star"		**Situata: Më pëlqen se…** Nxiten nxënësit të flasin rreth përjetimit nga dëgjimi muzikor i një muzike, nga një sjellje e kryer nga shoku, nga vëzhgimi i një vepre arti etj. Pse ne themi se ndihemi mirë ose keq? Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, duke përjetuar emocionet që i krijon kënga*; - identifikon karakterin e këngës që dëgjon dhe i shpjegon ato; - reflekton emocionet që i krijon muzika e këngës gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - karakteri i muzikës; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor 3-4 minuta, ku nxënësit/et dëgjojnë muzikën e këngës "Twinkle Twinkle Little Star". Pyeten nxënësit a kanë ndonjë film të preferuar? Ata tregojnë arsyen e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Twinkle, twinkle little star" dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. *Pse të pëlqen muzika që dëgjove?*
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse u pëlqen muzika. *Pse të pëlqen të këndosh apo vallëzosh?*

Teksti i këngës: "Twinkle Twinkle Little Star"

Twinkle, twinkle, little star.
How I wonder what you are.
Up above the world so high,
Like a diamond in the sky.
Twinkle, twinkle, little star.
How I wonder what you are.

Twinkle, twinkle, little star.
How I wonder what you are.
Up above the world so high,
Like a diamond in the sky.
Twinkle, twinkle, little star.
How I wonder what you are.

Duke parë figurat dhe duke dëgjuar muzikën e filmit "Twinkle Twinkle Little Star", mësuesi/ja nxit nxënësit/set të shprehin me fjalë të thjeshta emocionet që u krijohen nga ky film.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e karakterit të muzikës që dëgjon;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Këngë: "Lule Velo partizani"		**Situata: Dëshmori i qytetit/krahinës sime** Nxiten nxënësit të tregojnë historinë/ tregimin e një dëshmori që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta mbi muzikën dhe tekstin e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të tregojnë historinë/ tregimin e një dëshmori, që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Lule Velo partizani" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Pamje nga filmi "Partizani i vogël Velo"

Teksti i këngës: "Lule Velo partizani"

I
I le dhent' dole tek stani,
lule Velo partizani,
more pushkën dole malit,
Lule Velo partizani.

II
Po pyet nëna ç'u bë djali,
Lule Velo partizani
Ju përgjigjën krismat malit,
Lule Velo partizani.

III
Nëpër male, nëpër shkrepa,
Në çdo luft'që bënte çeta,
Në mes shok've rritej djali,
Lule Velo partizani.

IV
Priste nëna që ti vijë,
Partizan o me lirinë,
Dhe në syt' e çdo fëmije,
Shihte Shqipërin' e lirë.

Lule Velo partizani

Muzika: Kujtim Laro



■ **Gjatë mësimit të këngës,** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (këngët partizane);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Rrotull pemës po vallëzojmë"		**Situata: Festa që më pëlqen më shumë** Nxiten nxënësit të flasin rreth festave që festojnë me familjen e tyre dhe festën më të preferuar të tyre. Pse e pëlqejnë festën e Vitit të Ri?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - njohuri për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të flasin rreth festave që festojnë me familjen e tyre dhe festën më të preferuar të tyre. Pse e pëlqejnë festën e Vitit të Ri?			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Rrotull pemës po vallëzojmë" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: “Rrotull pemës po vallëzojmë”

I

Rrotull pemës po vall’zojmë,
Ne fëmijët me gëzim,
Oh sa bukur që këndojmë,
Sot për ty o vendi im.

II

Shihni shihni sa të qeshur,
Kush këndon, kush luan balet,
Rroba t’buk’ra kanë veshur,
Shihni sa u kan’ lezet.

III

Jashtë nis një bor’ e madhe,
Era vrullshëm fërshëllen,
Do ta ftojmë shpejt në valle,
Vitin e Ri që po na vjen.

Muzika: Tonin Harapi



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (festat e preferuara);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Glokenshpili/ksilofoni – instrumenti Orf		**Situata: Instrumenti im i preferuar** Vendosen disa foto apo instrumente muzikore në dërrasë të zezë dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glokenshpili? Po ksilofoni?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - ndërton me mjete rrethanore një nga veglat muzikore; - ksilofon/ glokenshpili, vetëm ose me të tjerët; - kupton rëndësinë e përdorimit të veglave me goditje; - shoqëron me veglat e krijuara këngë të ndryshme.		**Fjalët kyçe:** - instrument me goditje; - glokenshpil; - ksilofon.	
Burimet: - materiale dhe mjete të përgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - teknologjia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke vendosur disa foto apo instrumente muzikore dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka ksilofoni? Po glokenshpili?			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të lidhin me shigjetë emrin me instrumentin përkatës.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të shkruajnë disa rreshta rreth një instrumenti ORF që lëshojnë tinguj me më shumë se dy goditje.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur materialet e grumbulluara dhe udhëzohen për hapat që do të ndjekin për të ndërtuar instrumentin. Mësuesi/ja u rri pranë

atyre duke i mbështetur dhe duke u treguar mënyrën se si duhet të punojnë.
Nxënësit:
- ndahen në grupe për ndërtimin e instrumentit muzikor me goditje;
- ndjekin udhëzimet për ndërtimin e tij;
- diskutojnë me njëri-tjetrin për instrumentin muzikor;
- provojnë tingëllimin e instrumentit me goditje dhe i shpjegojnë ato;
- shoqërojnë këngët apo këngët-lojë me instrumente me goditje.

Hapi IV

Nxënësit/et diskutojnë efektet që krijon instrumenti me goditje, duke diskutuar rreth ndryshimit të tingëllimit dhe arsyet e këtij ndryshimi, si: *materiali, madhësia etj.*

Duke parë figurat e mëposhtme, mësuesi/mësuesja nxit nxënësit/set të evidentojnë instrumentin e ksilofonit dhe të glokenshpilit.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:
përgatitjen dhe ndërtimin e instrumentit me goditje;
- ndjekjen e udhëzimeve për ndërtimin e tij;
- shoqërimin e këngëve vetëm dhe në grup me instrumentet me goditje që u krijuan.

Detyra: Punët (instrumenti i ndërtuar) nga nxënësit ruhet në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Krijojmë modele me 2 goditje		**Situata: Unë dhe ritmi** U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me dy goditje nëpërmjet simboleve, goditjeve me shuplaka apo me instrumente me goditje. Shpjegojnë duke ritmizuar modelin e krijuar.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen dhe imiton ritme me dy goditje; - improvizon në ritme me dy goditje; - improvizon modele ritmike me dy goditje me gjatësi të ndryshme; - krijon modele me dy goditje dhe i shkruan ato në fletoren e vet.		**Fjalët kyçe:** - ritëm me dy goditje; - modele me gjatësi ritmike të ndryshme me dy goditje.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika; - gjuha.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi vazhdohet më tej me lojën dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësi tingujsh me dy goditje. Gjithashtu, ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të shkruajnë kush janë objektet që lëshojnë tinguj me dy goditje.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes, duke vëzhguar tabelën që iu paraqet mësuesi/ja, dhe të shkruajnë kush janë objektet që lëshojnë tinguj me më shumë se dy goditje.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të krijojnë sipas imagjinatës së tyre simbole që të japin idenë e një - dy goditjeve dhe të pushimit, *për shembull pika e shiut kur bie në tokë*.

Hapi IV

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke u vendosur sipër çdo rrokjeje simbolin e krijuar prej teje, i cili nënkupton 1 dhe 2 goditje apo pushimin.

Duke parë fjalët e mëposhtme, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të lexojnë dhe të shoqërojnë me instrumente me goditje.

1. **shko** —lla, **lap** — si, **ban** — ka, **pe** — ma, At — **dhe** — u, ma — **ki** — na, do — **lla** — pi, **ta** — vo — **li** — na, **bi** — çi — **kle** — ta, etj?

2.

>		-	>	-	>	-	>	-
një	ma	- çok	çama	rok	lara	lara	vija	vija
	god 1	god 2	god 1	god 2	god 1	god 2	god 1	god 2
	f	b	**f**	b	**f**	b	**f**	b

etj.

● **Zgjidh** një nga instrumentet e mëposhtme për të shoqëruar ushtrimet me rrokëzim.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: krijimi i modeleve ritmike me dy goditje;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të ritmit me dy goditje nëpërmjet simboleve;
- shoqërimin e shembujve ritmike me shuplaka dhe të regjistrimit grafik të krijuar vetëm ose në grup.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

PLANIFIKIMI[1], PERIUDHA: JANAR – MARS

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: 1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike; 2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen; 3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore; 4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë. **Kompetenca e të menduarit** Nxënësi/ja: 1. mendon në mënyrë krijuese; 2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese; 3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese; 4. kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë** Nxënësi/ja: 1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor; 2. përdor burime të gatshme për të realizuar një krijim muzikor; 3. zbaton detyrën e dhënë. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** Nxënësi/ja: 1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës. **Kompetenca personale** Nxënësi/ja: 1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore; 2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve; 3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave. **Kompetenca qytetare** Nxënësi/ja: 1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. **Kompetenca digjitale** Nxënësi/ja: 1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	**Interpretimi muzikor**	**Vlerësimi muzikor**
Nxënësi/ja: • krijon me modele ritmike me dy goditje; • krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe me simbole, duke vënë në pah *theksin e fortë* gjatë ritmizimit të tyre; • krijon duke përdorur simbole personale mbi ritmin me 2 goditje.	***Nxënësi/ja:*** • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë; • demonstron gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet • fëmijërore Orf me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe • të melodisë; • luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tri dhe katër goditje; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë, duke iu përshtatur tematikës së këngës; • respekton interpretimin e shokëve/ shoqeve; • respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • shpjegon emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo • fragment muzikor gjatë interpretimit.	***Nxënësi/ja:*** kupton, shpjegon dhe bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijohen; bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Nr.	Tematika[3]	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Burime dhe materiale
1	*T&P*	Këngа: "Milingona punëtore"	**Situata: "Punën e sotme mos e lër për nesër" – proverb** Nxiten nxënësit/et të shprehen rreth proverbit që dëgjojnë dhe të thonë pse është e dobishme puna.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
2	*GJ&KM*	Tingulli *shumë i lartë – shumë i ulët*	**Situata: Loja e gotave** Mbi tavolinë vendosen 5- 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm, të cilët në varësi të masës së ujit lëshojnë tinguj të lartë ose të ulët.. Nxënësit/et pasi godasin me një lugë gotat e mbushura përcaktojnë tingujt e lartë apo të ulët, duke i vendosur një shenjë.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
3	*T & P*	Glokenshpili – instrumenti Orf	**Situata: Instrumenti im i preferuar** Vendosen disa foto apo instrumente muzikore në dërrasë të zezë dhe pyeten nxënësit/et a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glokenshpili?	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

[3] GJ&KM - Gjuha dhe komunikimi muzikor; T&P - Teknika dhe procese; HM&SH - Historia, muzika dhe shoqëria

4	*HM&SH*	Muzika, përjetimi dhe emocioni - fragment nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri)*	**Situata: Pse më pëlqen...** Dëgjohen fragmente muzikore nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri)* dhe nxënësit/et nxiten të shprehin përjetimet e tyre ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
5	*GJ&KM*	Tingulli *shumë i fortë – shumë i butë*	**Situata: Loja e trokitjeve** Nxënësit nxiten të krijojnë një lojë me anë të trokitjeve të shuplakave e këmbëve dhe të shpjegojnë kuptimin e tingujve të butë dhe të fortë.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
6	*T&P*	Kënga: "Mësuesja ime"	**Situata: Respekt dhe dashuri** Shkruhen në dërrasë dy fjalët *respekt- dashuri* dhe nxiten nxënësit të shprehen lirshëm çfarë kuptojnë me këto dy fjalë. Pse ata duhet të respektojnë njerëzit që duan më shumë?	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

7	*HM&SH*	Muzika, kërcimi dhe fjala	**Situata: Muzika ime e parapëlqyer** Dëgjohen disa fragmente muzikore me këngë për fëmijë, muzikë filmi, apo valse të ndryshme. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre nëpërmjet kërcimi, fjalës apo vizatimit.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
8	*T&P*	Ndërtimi i instrumenteve me goditje	**Situata: Unë di të ndërtoj** Nxënësit/et vëzhgojnë instrumentin muzikor të parapëlqyer dhe përcaktojnë materialet me të cilat do të punojnë për ndërtimin e tij. Shpjegojnë përbërjen dhe tingullin që lëshon instrumenti muzikor që kanë ndërtuar.	- materiale të ricikluesshme; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
9	*T&P*	Tingulli *shumë i gjatë – shumë i shkurtër*	**Situata: Imitoj tingujt** Ndahen nxënësit/et në grupe dhe nxiten të imitojnë tinguj të ndryshëm, duke u kërkuar të shpjegojnë karakteristikat që ata krijojnë.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

10	*T&P*	Këngа: 'Erdh' pranvera"	**Situata: Stina e luleve** Nxënësit/et nxiten të flasin për kujdesin ndaj luleve dhe të rendisin hapat se si ata kujdesen për to.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
11	*T&P*	Këngа: "Merimanga"	**Situata: Spiderman** Nxënësit/et nxiten të flasin rreth insekteve, duke kujtuar personazhin aq të dashur të Spiderman-it.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
12	*HM&SH*	Muzika, përjetimi, emocionet - fragment nga muzika e baletit "Petja dhe ujku"	**Situata: Më pëlqen sepse...** Dëgjohen disa fragmente muzikore nga valse dhe balete të ndryshme. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas përjetimit që ata ndjejnë.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: 3-të
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Milingona punëtore"		**Situata: "Punën e sotme mos e lër për nesër" – proverb** Nxiten nxënësit të shprehen rreth proverbit që dëgjojnë dhe thonë pse është e dobishme puna.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - njohuri për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth proverbit që dëgjojnë dhe të thonë pse është e dobishme puna.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga "Milingona punëtore" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Milingona punëtore"

I

Çak, çak, çak, çak, si su lodhe dit' e nat',
Çak, çak, çak, çak, mbledh ushqimin pak nga pak,
Anë rrugës po kalon kjo milingona,
Sa her' vjen e sa her' shkon si nuk mërzitet,
Shum' kokrriza grumbullon kjo milingona,
Çdo njeri kur e shikon me të habitet.
Çak, çak, çak, çak, sis u lodhe dit' e nat',
Çak, çak, çak, çak, mbledh ushqimin pak nga pak,
Veç ajo e di çfar' heq kjo milingona,
Sepse lodhet pa pushim s'mërzitet fare,
Kur gjinkalla ka uri kjo milingona,
E ndihmon me bujari se ësht' bujare.

Refreni

Ti nuk rri por punon, të tjerët i dëgjon,
Nuk të intereson sheh punën tënde,
Ti nuk rri por punon, të tjerët i dëgjon,
Se ti vetëm jeton me djersën tënde.

II

Kam dëgjuar një përrall' por un' dyshova,
Se është një pun'tore e gjall' kjo milingona.
Por tani që e pash' vet' un' e besova,
Êsht' pun'tore e vërtet' kjo milingona

Refreni

Ti nuk rri por punon, të tjerët i dëgjon …….
Çak, çak, çak, çak, sis u lodhe……..

■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (punën);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Tingulli *shumë i lartë – shumë i ulët*		**Situata: Loja e gotave - tingëllimi** Mbi tavolinë vendosen 5- 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm, të cilët në varësi të masës së ujit lëshojnë tinguj të lartë ose të ulët. Nxënësit/et pasi godasin me një lugë gotat e mbushura përcaktojnë tingujt e lartë apo të ulët, duke i vendosur një shenjë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës Nxënësi/ja: - gjen dhe imiton tingujt *shumë të lartë – shumë të ulët*; - imiton tinguj të ndryshëm nga natyra apo muzika, të tingujve *shumë të lartë dhe shumë të ulët;* - përcakton tinguj të ndryshëm *shumë të lartë dhe shumë të ulët.*		**Fjalët kyçe:** - tingull shumë i lartë; - tingull shumë i ulët; - tinguj të ndryshëm.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku mbi tavolinë vendosen 5- 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm, të cilët në varësi të masës së ujit lëshojnë tinguj të lartë ose të ulët. Nxënësit/et pasi godasin me një lugë gotat e mbushura përcaktojnë tingujt e lartë apo të ulët, duke i vendosur një shenjë. Vazhdohet më tej me lojën dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë *shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë.*			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të sjellin shembuj të *një tingulli shumë të lartë dhe një tingulli shumë të ulët*.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes duke plotësuar vendet bosh, duke gjetur nëse tingujt që prodhohen nga figurat që shikojnë janë: *shumë të lartë - shumë të ulët.*

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të plotësojnë fjalitë me *e vërtetë apo e gabuar*.

Duke parë fjalët e mëposhtme, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të shpjegojnë me fjalë të thjeshta tingullin shumë të ulët dhe tingullim shumë të lartë.



Hapi IV

Mësuesi/sja i nxit nxënësit të këndojnë këngën duke vendosur shigjetën sipas lartësisë së zërit.



▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: kuptimi i tingujve shumë të lartë dhe shumë të ulët;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të tingujve shumë të lartë dhe shumë të ulët nëpërmjet simboleve.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika & procese **Tema mësimore:** Glokenshpili/ksilofoni – instrumenti Orf		**Situata: Instrumenti im i preferuar** Vendosen disa foto apo instrumente muzikore në dërrasë të zezë dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glokenshpili?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:mësimore: Nxënësi/ja: - ndërton me mjete rrethanore një nga veglat muzikore - glokenshpili, vetëm ose me të tjerët; - kupton rëndësinë e përdorimit të veglave me goditje; - shoqëron me veglat e krijuara këngë të ndryshme.		**Fjalët kyçe:** - instrument me goditje; - glokenshpil.	
Burimet: - materiale dhe mjete të përgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - teknologjia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke vendosur disa foto apo instrumente muzikore dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glokenshpili?			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të lidhin me shigjetë emrin me instrumentin përkatës.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të shkruajnë disa rreshta rreth një instrumenti ORF që lëshojnë tinguj me më shumë se dy goditje.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur materialet e grumbulluara dhe udhëzohen për hapat që do të ndjekin për të ndërtuar instrumentin. Mësuesi/ja u rri pranë atyre duke i mbështetur dhe duke u treguar mënyrën se si duhet të punojnë.

Nxënësit:
- ndahen në grupe për ndërtimin e instrumentit me goditje (glokenshpili);
- ndjekin udhëzimet për ndërtimin e tij;
- diskutojnë me njëri-tjetrin për instrumentin muzikor;
- provojnë tingëllimin e instrumentit me goditje dhe i shpjegojnë ato;
- shoqërojnë këngët apo këngët-lojë me instrumente me goditje.

Hapi IV

Nxënësit diskutojnë efektet që krijon instrumenti me goditje, duke diskutuar rreth ndryshimit të tingëllimit dhe arsyet e këtij ndryshimi, si: *materiali, madhësia etj.*

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:
- përgatitjen dhe ndërtimin e instrumentit me goditje;
- ndjekjen e udhëzimeve për ndërtimin e tij;
- shoqërimin e këngëve vetëm dhe në grup me instrumentet me goditje që u krijuan.

Detyra: Punët (instrumenti i ndërtuar) nga nxënësit ruhet në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika, përjetimi dhe emocioni - fragment nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri).*		**Situata: Pse më pëlqen...** Dëgjohen fragmente muzikore nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri)* dhe nxënësit nxiten të shprehin përjetimet e tyre ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valse, muzikë filmash* dhe edukohet me përqendrimin në dëgjim; - identifikon karakteristika dhe ndryshime të pjesëve që dëgjon, i dallon dhe i përcakton ato; - reflekton emocionet që i krijon muzika e filmit gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd me fragmente muzikore; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi, - historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë nga Karnavalet e kafshëve – Sen Sans (*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri)* dhe nxënësit nxiten të shprehin përjetimet e tyre ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohen fragmente të ndryshme muzikore nga filmi "Beni ecën vetë" dhe filma të tjerë shqiptarë dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. Pse të pëlqen muzika që dëgjove?
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse u pëlqen muzika? Pse të pëlqen të këndosh apo vallëzosh?

Duke parë fotot e mëposhtme dhe duke dëgjuar muzikën, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të shpjegojnë me fjalë të thjeshta mbi emocionet që u krijohen.

• Si do ta përjetonin nxënësit/set muzikën nëpërmjet arteve të tjera? Filmoni apo fotografoni veprimtarinë që ata kanë zgjedhur dhe depozitojeni atë në dosjen e tyre.



▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e llojeve të ndryshme muzikore;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Tingulli *shumë i fortë – shumë i butë*		**Situata: Loja e trokitjeve** Nxënësit nxiten të krijojnë një lojë me anë të trokitjeve të shuplakave e këmbëve dhe shpjegojnë kuptimin e tingujve të butë dhe të fortë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës Nxënësi/ja: - gjen dhe imiton tingujt *shumë të fortë – shumë të butë;* - gjen simbole që tregojnë tingujt *shumë të fortë – shumë të butë*; - demonstron përmes këndimit karakteristikat e tingujve të mësipërm; - dallon *karakteristikat e tingujve* në këngët e mësuara.		**Fjalët kyçe:** - tingull *shumë i fortë*; - tingull *shumë i butë*; - tinguj të ndryshëm.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit nxiten të krijojnë një lojë me anë të trokitjeve të shuplakave dhe këmbëve dhe shpjegojnë kuptimin e tingujve *të butë dhe të fortë.*

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me tri ndalesa, duke e ndarë dëgjimin e tingujve dhe gjetjen e karakteristikave të tyre në tri momente. Ai/ajo mund të bëjë një veprimtari konkrete me nxënësit përmes këndimit dhe regjistrimit grafik të tingujve që ata këndojnë.

Hapi I

Vihen në CD shembuj muzikor të një tingulli shumë të fortë dhe shumë të butë.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të plotësojnë në fletoren e tyre vendet bosh, duke gjetur nëse tingujt që prodhohen nga figurat që shikon janë: shumë të fortë - shumë të butë.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të plotësojnë fjalitë nëse është e vërtetë apo e gabuar.

Duke parë figurat e mëposhtme dhe duke dëgjuar muzikën, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të imitojnë dhe të shprehin karakteristikat e tingullit të fortë e të butë.

tingulli i fortë

tingulli i butë

Vazhdo ti tani...

▶***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: kuptimi i tingujve *shumë të fortë – shumë të butë*;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të tingujve *shumë të fortë – shumë të butë* nëpërmjet simboleve.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Mësuesja ime"		**Situata: Respekt dhe dashuri** Shkruhen në dërrasë dy fjalët *respekt - dashuri* dhe nxiten nxënësit të shprehen lirshëm çfarë kuptojnë me to. Pyeten pse ata duhet të respektojnë njerëzit që duan më shumë?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësuesi/ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen rreth festave të ndryshme që kanë festuar në klasë, shkollë, familje apo komunitet. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit festën që u pëlqen më shumë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Mësuesja ime" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Mësuesja ime"

I

Klasa më e mirë ne të gjith' na thon'
Mësuesja ime bukur na shpjegon,
Tregime, mësime, shkrim edhe lexim,
Kur na pyet mësuesja të gjitha i dim'.

Refreni

Të dua, të dua,
Mësuesja ime,
Do të jesh gjithmon'
Ti në zemrën time.

II

Ditarin me dhjeta ne e kemi mbush,
Për dituri shkollore, s'na i kalon askush,
Me shok' e me shoqe detyrat punojm',
Mësuesen ton' kështu e gëzojm'.

Refreni

Të dua, të dua,
Mësuesja ime,
Do të jesh gjithmon'
Ti në zemrën time.



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (për mësuesin);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika, kërcimi dhe fjala		**Situata: Muzika ime e parapëlqyer** Dëgjohen disa fragmente muzikore me këngë për fëmijë, muzikë filmi, apo valse të ndryshme. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre nëpërmjet kërcimi, fjalës apo vizatimit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valse, këngë-lojë me recitativ* dhe edukohet të kombinojë muzikën me arte të tjera; - identifikon karakteristika të muzikës që dëgjon, duke veçuar disa prej tyre; - improvizon me lëvizjet trupore muzikën që dëgjon; - reflekton emocionet që i krijon muzika e dëgjuar, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd me fragmente muzikore; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me lëndët e tjera:** - letërsia. - kërcimi. - edukimi fizik. - edukimi figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke dëgjuar disa fragmente muzikore me këngë për fëmijë, muzikë filmi, apo valse të ndryshme. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre nëpërmjet kërcimi, fjalës apo vizatimit.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohen fragmente të ndryshme muzikore me melodi të ndryshme dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. *Pse të pëlqen muzika që dëgjove?*
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse u pëlqen muzika. *Pse të pëlqen të këndosh apo vallëzosh?*

Mësuesi/sja ndan nxënësit/set në grupe dhe i nxit ata të krijojnë *një pikturë, një poezi apo lëvizje të ndryshme ritmike.*

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e llojeve të ndryshme muzikore;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Ndërtimi i instrumenteve me goditje		**Situata: Unë di të krijoj** Nxënësit vëzhgojnë instrumentin muzikor të parapëlqyer dhe përcaktojnë materialet me të cilat do të punojnë për ndërtimin e tij. Shpjegojnë përbërjen dhe tingullin që lëshojnë instrumentet muzikore që kanë ndërtuar.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - ndërton me mjete rrethanore instrumentet muzikore orf me goditje, vetëm ose me të tjerët; - kupton rëndësinë e përdorimit të veglave me goditje; - shoqëron me veglat e krijuara këngë të ndryshme.		**Fjalët kyçe:** - instrument me goditje; - Glokenshpil.	
Burimet: - materiale të ricikluesshme; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - teknologjia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke vendosur disa foto dhe materiale të ricikluesshme për krijimin e instrumenteve muzikore dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Prej çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash kanë këto instrumente?			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Hapi I

Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të lidhin me shigjetë emrin me instrumentin përkatës.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të shkruajnë disa rreshta rreth një instrumenti ORF që lëshojnë tinguj të ëmbël dhe tinguj të ftohtë.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur materialet e grumbulluara dhe udhëzohen për hapat që do të ndjekin për të ndërtuar instrumentin. Mësuesi/ja u rri pranë atyre duke i mbështetur dhe duke u treguar mënyrën se si duhet të punojnë.

Nxënësit:
- ndahen në grupe për ndërtimin e instrumentit me goditje (ksilofon, shkopinj, trekëndëshi, tambur etj.);
- ndjekin udhëzimet për ndërtimin e tij;
- vendosen tastet prej dërrase nga më e vogla te më e madhja;
- në një kuti metalike ku vendoset sipër tullumbaci i tendosur etj;
- diskutojnë me njëri-tjetrin për instrumentin muzikor;
- provojnë tingëllimin e instrumentit me goditje dhe i shpjegojnë ato;
- shoqërojnë këngët apo këngët-lojë me instrumente me goditje.

Hapi IV

Nxënësit/et diskutojnë efektet që krijon instrumenti me goditje, duke diskutuar rreth ndryshimit të tingëllimit dhe arsyet e këtij ndryshimi, si: *materiali, madhësia etj.*

Duke parë figurat e mëposhtme, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të flasin me fjalë të thjeshta për karakteristikat e këtyre instrumenteve të mëposhtme.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:
përgatitjen dhe ndërtimin e instrumentit me goditje;
- ndjekjen e udhëzimeve për ndërtimin e tij;
- shoqërimin e këngëve vetëm dhe në grup me instrumentet me goditje që u krijuan.

Detyra: Punët (instrumenti i ndërtuar) nga nxënësit ruhet në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Tingulli *shumë i gjatë – shumë i shkurtër*		**Situata: Imitoj tingujt** Ndahen nxënësit në grupe dhe nxiten të imitojnë tinguj të ndryshëm, duke u kërkuar të shpjegojnë karakteristikat që ata krijojnë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen dhe imiton tingujt *shumë të gjatë – shumë të shkurtër;* - gjen simbole që tregojnë tingujt *shumë të gjatë – shumë të shkurtër*; - demonstron përmes këndimit karakteristikat e tingujve të mësipërm; - dallon *karakteristikat e tingujve* në këngët e mësuara.		**Fjalët kyçe:** - tingull *shumë i shkurtër*; - tingull *shumë i gjatë*; - tinguj të ndryshëm.	
Burimet: - Cd me shembuj; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit ndahen në grupe dhe nxiten të imitojnë tinguj të ndryshëm, duke u kërkuar të shpjegojnë karakteristikat që ata krijojnë.

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me tri ndalesa, duke e ndarë dëgjimin e tingujve dhe gjetjen e karakteristikave të tyre në tri momente. Ai/ajo mund të bëjë një veprimtari konkrete me nxënësit/et përmes këndimit dhe regjistrimit grafik të tingujve që ata/ato këndojnë.

Hapi I

Vëzhgo figurat dhe shkruaj tingullin që lëshon secila prej tyre.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të gjejnë, në ambientin e shkollës, objekte që prodhojnë tinguj shumë të gjatë dhe tinguj shumë të shkurtër dhe ti shënojne ato në dërrasë apo fletore.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të provojnë të luajnë modelin ritmik të mëposhtëm, duke shoqëruar me rrahjen e duarve.



Duke parë figurat e mëposhtme, mësuesi/ja nxit nxënësit/set të flasin me fjalë të thjeshta për karakteristikat e tingullit që dëgjojnë.

tingull shumë i gjatë

tingull shumë i shkurtër

Vazhdo ti tani...

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: kuptimi i tingujve *shumë të gjatë – shumë të shkurtër*;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të tingujve *shumë të gjatë – shumë të shkurtër* nëpërmjet simboleve.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Këngë: 'Erdh' pranvera"		**Situata: Stina e luleve** Nxënësit nxiten të flasin për kujdesin ndaj luleve dhe të rendisin hapat se si ata kujdesen për to.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - njohuri për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth stinëve të vitit. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit festën që u pëlqen më shumë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Erdh pranvera" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Erdh pranvera

I

Erdhi pranvera erdhi përsëri,
Un'pash' një dallëndyshe ja se se e di.
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Ne pam' një dallëndyshe ja se se e dim'.
Fluturon shpejt si shigjet,
Ai shkon me krah' të leht',
Ngren folenë në një streh',
Por cila eshte dita e parë e pranver's?
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Un' pash' një lule vjollc'
ja se si e di.
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Ne pam' një lule vjollc'
ja se si e dim'.
er' e kënd'shme po na i vjen,
ngjyr' e saj po na pëlqen,
dhe oborr po zbukuron,
Por cila eshte dita e parë e pranver's?
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Un' pash' nje bletë
ja se si e di.
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Ne pam' nje bletë
ja se si e dim'.
Punëtore pa përtes',
Aq e vogël dhe e leht',
Ka për mjaltin aq talent,
Por cila është dita e parë e pranver's?
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Un' pash' një flutur
ja se si e di.
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Ne pam' një flutur
ja se si e dim'.
Zonj' e bukur fluturo,
Krahëshkruar valëzon,
Ngjyra ngjyra shkon e vjen,
Por cila është dita e parë e pranver's?
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Un' pash' një bretkoc
ja se si e di.
Erdhi pranvera, erdhi përsëri,
Ne pam' një bretkoc
ja se si e dim'.
Kafsh' e vogël guek, guek, guek
Ku e ke bishtin pse se ke,
Shalë gjatë moj kok' përpjet',
Por cila është dita e parë e pranver's?



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (stinët dhe veçanërisht pranverën);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Merimanga"		**Situata: Spiderman** Nxënësit nxiten të flasin rreth insekteve duke kujtuar personazhin aq të dashur të Spiderman-it.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - biologjia; - njohuri për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehen se pse është e dobishme puna. Mësuesi/ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen të flasin rreth insekteve duke kujtuar personazhin aq të dashur të Spiderman-it. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë e ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që të skicojnë përmes vizatimit festën që u pëlqen më shumë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Merimanga" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Merimanga"

I

Un' jam zonja merimanga,
E ndërtoj shtëpin' me pranga,
Kush nuk do që t'a besoj,
Po të doj' le t'a provoj.
E thurr fijen rreth e qark
Dhe për vete rri rehat,
Gjysëm fjetur në përgjim,
Mjer ai që bën gabim.

Refreni

Gjith' ata që jan' mistreca
Miza, flutra, karkaleca,
Që kujtojn' se kan' guxim,
Përfundojn' në kurthin tim.
Ha ha ha ha ha ha ha ha…

II

Pa projekte pa gentplan,
Kur pezhishka në tavan,
Cep më cep si pelivan,
Sa të gjith' zili më kan'.
Dhe algjebër, gjeometri,
Nuk kam furça as mistri,
Nuk studioj inxhinieri,
Ndërtoj shpi për mrekulli.

Refreni

Gjith' ata që jan' mistreca……
Un' jam zonja merimanga.

■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (insektet);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika, përjetimi dhe emocioni - fragment nga muzika e baletit "Petja dhe ujku"		**Situata: Më pëlqen sepse...** Dëgjohen disa fragmente muzikore nga valse dhe balete të ndryshme. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas përjetimit që ata ndjejnë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon me vëmendje muzikën e baletit dhe përjeton emocionet që i jep ajo; - flet për muzikën, duke shpjeguar *pse*; - reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, edhe nëpërmjet arteve të tjera: *kërcim, ese, poezi, vizatim*.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - muzikë baleti; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd fragment nga baleti "Petja dhe ujku"; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - kërcimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor nga muzika e baletit "Petja dhe ujku". Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të, sipas përjetimit emocional që ata ndjejnë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet fragment muzikor nga muzika e baletit "Petja dhe ujku" dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. *Pse të pëlqen muzika që dëgjove?*
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse u pëlqen muzika? *Pse të pëlqen të këndosh apo vallëzosh?*
- Mësuesi/ja u kërkon nxënësve nëse njohin njohin apo kanë parë balete të tjera.

Duke parë fotot dhe dëgjuar muzikën nga baleti "Petja dhe ujku" nga Prokofievi, mësuesi/mësuesja nxit nxënësit/set të flasin me fjalë të thjeshta mbi emocionet që u krijon kjo pjesë.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e llojeve të ndryshme muzikore;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

PLANIFIKIMI TREMUJOR1, PERIUDHA: PRILL – QERSHOR

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: 1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike; 2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen; 3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore; 4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë. **Kompetenca e të menduarit** Nxënësi/ja: 1. mendon në mënyrë krijuese; 2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese; 3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese; 4. kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë** Nxënësi/ja: 1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor; 2. përdor burime të gatshme për të realizuar një krijim muzikor; 3. zbaton detyrën e dhënë. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** Nxënësi/ja: 1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës. **Kompetenca personale** Nxënësi/ja: 1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore; 2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve; 3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave. **Kompetenca qytetare** Nxënësi/ja: 1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. **Kompetenca digjitale** Nxënësi/ja: 1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	**Interpretimi muzikor**	**Vlerësimi muzikor**
Nxënësi/ja: • krijon me modele ritmike me dy goditje; • krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe me simbole, duke vënë në pah *theksin e fortë* gjatë ritmizimit të tyre; • krijon duke përdorur simbole personale mbi ritmin me 2 goditje.	***Nxënësi/ja:*** • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë; • demonstron gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet • fëmijërore Orf me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe • të melodisë; • luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tri dhe katër goditje; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; • respekton interpretimin e shokëve/ shoqeve; • respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • shpjegon emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo • fragment muzikor gjatë interpretimit.	***Nxënësi/ja:*** kupton, shpjegon dhe bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijohen; bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Nr.	Tematika[4]	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Burime dhe materiale
1	*T&P*	Improvizime të ritmeve nga melodi popullore	**Situata: Luajmë dhe vallëzojmë** Vendosen disa fragmente të ndryshme nga vallet popullore dhe nxiten nxënësit të improvizojnë lëvizje me anë të trupit. Cili është kërcimi i preferuar i tyre? Pse....	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
2	*GJ&KM*	Tempi - shpejt/ ngadalë, përjetimi muzikor	**Situata: Luaj dhe krijoj** Nxënësit dëgjojnë disa ritme të krijuara nga mësuesi/ja dhe mundohen të krijojnë simbolin grafik që i përfaqëson këto goditje të gjata dhe të shkurtra. Diskutojnë krijimet e tyre me njëri-tjetrin.	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
3	*T&P*	Kënga: "Il cocodrillo come fa"	**Situata: Këndoj në gjuhë të huaj** Renditen disa fjalë të huaja përshëndetëse dhe u kërkohet nxënësve të gjejnë kuptimin e tyre. Më pas nxiten të flasin përse është e mirë mësimi i gjuhës së huaj?	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

[4] GJ&KM - Gjuha dhe komunikimi muzikor; T&P - Teknika dhe procese; HM&SH - Historia, muzika dhe shoqëria

4	*HM&SH*	Emocionet dhe muzika - përjetimi përmes muzikës dhe fjalës	**Situata: Luajmë dhe vallëzojmë** Vendosen disa fragmente të ndryshme nga vallet popullore dhe nxiten nxënësit të improvizojnë lëvizje me anë të trupit. Cili është kërcimi i preferuar i tyre? Pse....	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
5	*GJ&KM*	Pauza ose pushimi në muzikë	**Situata: Fjalia dhe shenjat e pikësimit** Nxiten nxënësit të shpjegojnë domethënien e shenjave të pikësimit në fjali p.sh.: pikës dhe presjes. Pse ndalohet zëri kur kemi pikë? Por kur kemi presje? Po në muzikë si quhet momenti i pushimit?	- Cd; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
6	*T&P*	Kënga: "Cicërimat e zogjve të pyllit"	**Situata: Shpendët** Nxënësit/et imitojnë veprimet që bëjnë kur u rastis të komunikojnë me një shpend p.sh.: një zog. Çfarë gjuhe përdorin ata? A mendojnë se shpendët kuptojnë? Nëse jo pse?	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.

7	*T&P*	Kënga: "Shqipërisë i ngjaj"	**Situata: Vendi im** Nxënësit/et nxiten të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ ato, bëjnë një udhëtim imagjinar duke përdorur mjete të tilla shprehëse, si: fjalën, vizatimin, tregimin etj.	- Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.
8	*T&P*	Interpretimi më i bukur		
9	*T&P*	Koncert		- **Cd**
10	*T&P*	Koncert		- **Cd**

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Improvizime të ritmeve nga melodi popullore		**Situata: Luajmë dhe vallëzojmë** Vendosen disa fragmente të ndryshme nga vallet popullore dhe nxiten nxënësit të improvizojnë lëvizje me anë të trupit. Cili është kërcimi i preferuar i tyre? Pse...	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - improvizon ritme nga melodi popullore, duke përdorur lëvizjet trupore apo mjetet trupore *(shuplakat, këmbët* etj.); - krijon *modele ritmike nga melodi shumë thjeshta* dhe i paraqet ato nëpërmjet *simboleve* të thjeshta para klasës.		**Fjalët kyçe:** - lëvizje trupore.	
Burimet: - Cd me fragmente muzikore popullore; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke vendosur disa fragmente të ndryshme nga vallet popullore dhe nxiten nxënësit të improvizojnë lëvizje me anë të trupit. Cili është kërcimi i preferuar i tyre? Pse...			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me disa hapa, si më poshtë vijon.

Hapi I

Vendosen për dëgjim disa fragmente nga muzika popullore dhe nxiten nxënësit të krijojnë lëvizje të ndryshme trupore, sipas melodisë që dëgjon, duke u kërkuar të shpjegojnë pse…

Hapi II

U kërkohet nxënësve të dëgjojnë fragmentet e kënduara ose të luajtura në instrumente dhe të shpjegojnë ndryshimin e ritmeve që dëgjojnë midis tyre.

Hapi III

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke u kërkuar të krijojnë *modele ritmike nga melodi shumë thjeshta* dhe t'i paraqesin ato nëpërmjet *simboleve* të thjeshta para klasës. Vendosi të provojnë të luajnë modelin ritmik të mëposhtëm, duke shoqëruar me instrumente me goditje.



Mësuesi/sja ndan nxënësit/set në grupe dhe i nxit ata të krijojnë figura ritmike të ndryshme duke i interpretuar ato, nëpërmjet lëvizjeve trupore.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- improvizimin nga melodi popullore, duke përdorur lëvizjet trupore apo mjetet trupore *(shuplakat, këmbët* etj);
- krijimin e *modeleve ritmike nga melodi shumë thjeshta,* duke i paraqitur ato nëpërmjet *simboleve* të thjeshta para klasës.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Tempi - shpejt/ngadalë, përjetimi muzikor		**Situata: Luaj dhe krijoj** Nxënësit dëgjojnë disa modele ritmike të krijuara nga mësuesi dhe mundohen të krijojnë simbolin grafik që i përfaqëson këto goditje të gjata apo të shkurtra apo nëpërmjet rrokjeve (fjalës). Diskutojnë krijimet e tyre me njëri - tjetrin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen dhe imiton tingujt *shumë i gjatë – shumë i shkurtër;* - gjen simbole që përfaqësojnë tingujt *shumë të gjatë – shumë të shkurtër*; - gjen dhe demonstron përmes këndimit karakteristikat e tingujve të mësipërm; - dallon *karakteristikat e tingujve* në këngët e mësuara.		**Fjalët kyçe:** - tingull *shumë i shkurtër*; - tingull *shumë i gjatë*; - tinguj të ndryshëm.	
Burimet: - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit ndahen në grupe dhe nxiten të imitojnë tinguj të ndryshëm, duke u kërkuar të shpjegojnë karakteristikat që ata krijojnë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me tri ndalesa, duke e ndarë dëgjimin e tingujve dhe gjetjen e karakteristikave të tyre në tri momente. Ai/ajo mund të bëjë një veprimtari konkrete me nxënësit/et përmes këndimit dhe regjistrimit grafik të tingujve që ata/ato këndojnë.

Hapi I

Vëzhgo figurat dhe shkruaj tingullin që lëshon secili prej tyre.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të këndojnë këngën-lojë "Ne jemi dy shqiponja" (ose çfarëdolloj kënge apo loje muzikore tjetër). Në strofën e parë, vendos numrat 1 dhe 2 për çdo rrokje të fjalëve të këngës.

Hapi III

U kërkohet nxënësve të shkruajnë me anë të rrokjeve TA (tingull i gjatë) dhe ti – ti (tingujt e shkurtër) tingujt që dëgjojnë nga Cd.





Hapi IV

Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të provojnë dhe të shpjegojnë simbolet e paraqitura për tingujt që dëgjojnë, duke i shoqëruar me zë, me rrahjen e duarve apo me modele grafike.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: kuptimi i tingujve *shumë të fortë – shumë të butë*;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të tingujve *shumë të fortë – shumë të butë* nëpërmjet simboleve.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Il cocodrilo come fa"		**Situata: Këndoj në gjuhë të huaj** Renditen disa fjalë të huaja përshëndetëse dhe u kërkohet nxënësve të gjejnë kuptimin e tyre. Pastaj nxiten të flasin përse është i mirë mësimi i gjuhës së huaj?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - biologjia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku mësuesi/ja rendit disa fjalë të huaja përshëndetëse dhe u kërkohet nxënësve të gjejnë kuptimin e tyre. Më pas nxiten të flasin përse është i mirë mësimi i gjuhës së huaj? Bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth proverbit që dëgjojnë dhe thonë pse është e dobishme puna.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Il cocodrilo come fa" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Il cocrodillo come fa"

Oggi tutti insieme
cercheremo di imparare
come fanno per parlare
fra di loro gli animali.
come fa il cane? bau bau
e il gatto? miao

l' asinello? hi hoo hi hoo
recitativ
la mucca? muuuuu...!!!
la rana? cra cra
la pecora? beee...!!!
e il coccodrillo?...
e il coccodrillo?...
boh..!!!
il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si dice mangi troppo
non metta mai il cappotto
che con i denti punga
che molto spesso pianga
però quand' è tranquillo come fa sto
coccodrillo?...
il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si arrabbia ma non strilla
sorseggia camomilla
e mezzo addormentato se ne va.
guardo sui giornali
non c'è scritto niente
sembra che il problema non importi...A chi?
alla gente
ma se per caso al mondo
c'è qualcuno che lo sa
la mia domanda è ancora questa qua!

il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si dice mangi troppo
non metta mai il cappotto
che con i denti punga
che molto spesso pianga
però quand' è tranquillo come fa sto
coccodrillo?...
il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si arrabbia ma non strilla
sorseggia camomilla
e mezzo addormentato se ne va.
adesso ripetiamo se vogliamo ricordare
come fanno per parlare
tra di loro gli animali
come fa il cane? bau bau
e il gatto? miao
l' asinello? hi hoo hi hoo
la mucca? muuuuu...!!!
la rana? cra cra
la pecora? beee...!!!
e il coccodrillo?...
e il coccodrillo?...
boh..!!!
il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si dice mangi troppo
non metta mai il cappotto
che con i denti punga
che molto spesso pianga
però quand' è tranquillo come fa sto
coccodrillo?...
il coccodrillo come fa
non c'è nessuno che lo sa
si arrabbia ma non strilla
sorseggia camomilla
e mezzo addormentato se ne va.
allora, avete capito come fa il coccodrillo?
lui mezzo addormentato se ne va!

■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Emocionet dhe muzika - Përjetimi përmes muzikës dhe fjalës		**Situata: Unë dhe muzika** Vendoset fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë muzikë të ndryshme. Pyeten nxënësit pse ju pëlqen muzika? Ata tregojnë arsyen e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valse, muzikë filmash* dhe edukohet me përqendrimin në dëgjim; - identifikon karakteristika dhe ndryshime të pjesëve që dëgjon, i dallon dhe i përcakton ato; - reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - kërcim; - përjetim emocional.	
Burimet: - Cd me pjesë muzikore; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi, - historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon duke dëgjuar fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë muzikë të ndryshme. Pyeten nxënësit pse ju pëlqen muzika? Ata tregojnë arsyen e preferencave që kanë për këngë apo pjesë muzikore.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohen fragmente të ndryshme muzikore dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm:

- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. *Pse të pëlqen muzika që dëgjove?*
- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta pse të pëlqen muzika? *Pse të pëlqen të këndosh apo të vallëzosh?*

Duke dëgjuar, vallëzuar dhe kënduar, mësuesi/sja i nxit nxënësit/set të shprehen me fjalë të thjeshta pse ju pëlqen muzika.

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- këndimin me emocion të këngës, kërcimit, të shprehjes së mendimeve rreth muzikës;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor **Tema mësimore:** Pauza ose pushimi në muzikë		**Situata: Fjalia dhe shenjat e pikësimit** Nxiten nxënësit të shpjegojnë domethënien e shenjave të pikësimit në fjali p.sh.: pikës dhe presjes. Pse ndalohet zëri kur kemi pikë? Por kur kemi presje? Po në muzikë si quhet momenti i pushimit?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - demonstron kuptimin e pushimit në shembujt e paraqitur; - ligjërojnë biseda (ushtrime) muzikore me shenjën e pushimit; - gjen dhe demonstron përmes këndimit momentin e pushimit/pauzës.		**Fjalët kyçe:** - pauza/pushimi në muzikë.	
Burimet: - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit ndahen në grupe dhe nxiten të imitojnë tinguj të ndryshëm, duke u kërkuar të shpjegojnë karakteristikat që ata krijojnë.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me disa hapa dhe nxit nxënësit të shpjegojnë domethënien e shenjave të pikësimit në fjali p.sh.: pikës dhe presjes. Pse ndalohet zëri kur kemi pikë? Por kur kemi presje? Po në muzikë si quhet momenti i pushimit?

Hapi I

Vëzhgo ushtrimin dhe ligjëro duke numëruar me goditje. Më pas u kërkohet që të gjejnë sa pushime ka në ushtrim.

Hapi II

U kërkohet nxënësve të ligjërojnë duke zhvilluar bisedë muzikore me dy grupe.

Hapi III

U kërkohet nxënësve të shkruajnë goditjet dhe pushimet për çdo masë.



• Cili nga këto objekte krijon pauzën ose pushimin?

☐ ☐ ☐

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- demonstrimin e kuptimit të pushimit në shembujt e paraqitur;
- ligjërimin në krijimet (biseda/ushtrime) muzikore me shenjën e pushimit;
- demonstrimin përmes këndimit momentin e pushimit/pauzës.

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Cicërimat e zogjve të pyllit"		**Situata: Shpendët** Nxënësit/et imitojnë veprimet që ata bëjnë kur ju rastis të komunikojnë me një shpend p.sh., një zog. Çfarë gjuhe përdorin ata? A mendojnë se shpendët kuptojnë? Nëse jo pse?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi; - biologjia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku mësuesi/ja u kërkon nxënësve të imitojnë veprimet që ata bëjnë kur ju rastis të komunikojnë me një shpend p.sh., një zog. Çfarë gjuhe përdorin ata? A mendojnë se shpendët kuptojnë? Nëse jo pse?			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Cicërimat e zogjve të pyllit" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Cicërimat e zogjve të pyllit"

Ga ga gag a, gu gu gu gu gu gu gu,
Cërr cërr cërr cërr, ci ci ci ci ci ci,
Trili,trili, trili e çing çing
Tuk e tuk e çik e çik.

I

Na erdh' pranvera bleroi pylli,

Gardalina kang's jam err, bashk' me të trishtili.
Cërrcamini e çurudhukla,
Një bishkuq, një gushbardh'
Gushpeci edhe mullizeza,
Një trumcak këndon me radh'
Edhe bishtdylberja.

Refreni
Në pyllin e gjelbruar, ndihet një melodi,
Ansambli i madh i zogjve t'ri
Me ga gag a e gu, gu, gu, cërr, cërr e ci ci ci ci
Sa bukuri.

II
Kërr, kërr kërr kërr këndon bishtundësi,
Dhe kalanda trilili, çing, çing, çing gushkuqi,
Çik, çik çika tuk qukapiku
Po dëgjohen deri vonë.
Gjith' zërat ëmbël kombinohen,
Shum' të harmonishëm janë, sa bukur dëgjohen
Kur një vardon iso i mban,
si një trombon.

Refreni
Në pyllin e gjelbruar, ndihet një melodi,….
Finalja
Dit' e për dit' sa zbardhet drit'
Gjer' n'prendim t'diellit, gjith' zogjt'e pyllit këndojn'.

Refreni
Në pyllin e gjelbruar…

Cicërimat e zogjve të pyllit

Teksti dhe muzika: Lec Balca



■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Shqipërisë i ngjaj"		**Situata: Vendi im** Nxënësit/et nxiten të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ato bëjnë një udhëtim imagjinar duke përdorur mjete të tilla shprehëse, si: fjalën, vizatimin, tregimin etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës; - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - Cd me këngën; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuha dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari ku mësuesi/ja nxit nxënësit të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ato bëjnë një udhëtim imagjinar, duke përdorur mjete të tilla shprehëse, si: fjalën, vizatimin, tregimin etj.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohet kënga: "Shqipërisë i ngjaj" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Teksti i këngës: "Shqipërisë i ngjaj"

I

Sot i madh nuk jam, por ngjaj me ty,
Këtu të kam o nëna Shqipëri.
Koha do të shkoj, do bëhem burr',
Dhe do qëndroj shqipja në flamur.

Refreni

Shqipëri moj Shqipëri ti më mbush me krenari,
O hej o hej u rritëm tok me ty.
Shqipëri moj Shqipëri ti, më mbush me krenari,
O hej o hej u rritëm tok me ty.
Eja ti dhe ti, nga jugu në veri,
O hej, o hej, o hej s'do mbaroj kjo melodi.
Eja ti dhe ti, nga jugu në veri,
O hej, o hej, o hej s'do mbaroj kjo melodi.
La la la…

II

Ikën dita sot dhe tjetra vjen,
O hej,o hej do mbetesh ti atdhe,
Emri shqiptar na ndrin në sy,
Një yll, një zjarr shikojn'na kan' zili
Refreni
Shqipëri moj Shqipëri ti më mbush me krenari,
O hej o hej u rritëm tok me ty.
Shqipëri moj Shqipëri ti, më mbush me krenari,
O hej o hej u rritëm tok me ty……
La la la…..

Refreni

Shqipëri moj Shqipëri ti më mbush me krenari,
O hej o hej u rritëm tok me ty……..

■ **Gjatë mësimit të këngës,** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

▶***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: II	Klasa: III
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Intepretimi më i bukur		**Situata: Koncerti im i preferuar** Organizohet një koncert për mbylljen e vitit shkollor. ku paraqiten këngët dhe vallet më të bukura të mësuara gjatë vitit shkollor.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - zgjedh pjesë të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valle, poezi etj*; - identifikon karakteristika dhe ndryshime të pjesëve që dëgjon, i dallon dhe i përcakton ato; - reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - interpretimi.	
Burimet: - Cd me pjesë muzikore; - materiale të parapërgatitura; - fletorja e nxënësit; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi, - historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë; - edukimi fizik; - kërcimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Organizohet një koncert për mbylljen e vitit shkollor. ku paraqiten këngët dhe vallet më të bukura të mësuara gjatë vitit shkollor.			

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

Dëgjohen fragmente të ndryshme muzikore dhe **vazhdohet** puna sipas hapave të mëposhtëm. Ndajini në 4 grupe nxënësit:

Hapi I

- Diskutojnë, duke rikujtuar këngët më të bukura gjatë këtij viti.
- Përcaktoni këngëtarët dhe këngët që do të këndohen.

Hapi II

- Diskutoni për poezitë më të bukura, duke përcaktuar edhe recituesit.
- Përzgjidhni poezitë më të mira me tematikë për atdheun, shkollën, shokët,
- familjen, ambientin, natyrën etj., por mos harroni edhe krijimet tuaja.

Hapi III

- Përcaktoni vallet që ju pëlqejnë më shumë duke zgjedhur kërcimtarët më të mirë klasës.

Hapi IV

- Shoqëroni këngët dhe vallet me instrumentet ORF, duke përcaktuar instrumentet dhe instrumentistët e klasës.

Duke parë fotot e mëposhtme mësuesi/mësuesja, ju kërkon nxënësit/nxënëses të interpretojnë bukur materialet e gjetura (këngë, recitime, valle, instrumente).

▶ ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- këndimin me emocion të këngës, kërcimit, të shprehjes së mendimeve rreth muzikës;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

1. VLERËSIMI

Llojet e vlerësimit

Vlerësimi *për të nxënë,* i nxënësit kryhet nëpërmjet: *vlerësimit të vazhduar, vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse dhe vlerësimit të portofolit të nxënësit.*
Vlerësimi *i të nxënit,* të nxënësit kryhet nëpërmjet: vlerësimit periodik dhe vlerësimit përfundimtar. *Vlerësimi i vazhduar* për të nxënit është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura. Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit/es mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit/es me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj. Për vlerësimin e vazhduar, mësuesi/ja përdor evidenca të arritjes së rezultateve të të nxënit, sipas niveleve të arritjes, për të mbledhur informacione të dobishme për të nxënit e nxënësve. Mësuesi/ja është i/e lirë të përshtatë formatin e evidencës në varësi të specifikave të lëndës. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, komente, fjalë etj., referuar niveleve të arritjes[1].

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse, ka për qëllim të mbledhë informacion për arritjet e nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni në përfundim të tremujorit. Testi/detyra përmbledhëse organizohet nga mësuesi/ja i/e lëndës për të siguruar informacion nëse përparimi i nxënësve është në rrugën e duhur apo duhen ndërmarrë hapa për përmirësime të mundshme.

Vlerësimi me portofol, ka për qëllim vëzhgimin dhe vlerësimin e nxënësit në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për fushën, lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, kreativitetin, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët. Portofoli përmban koleksion të organizuar të:

- punëve dhe detyrave të pavarura, të kryera në klasë dhe jashtë saj;

- projekteve individuale ose në grup;

- detyrave dhe kontributeve të krijuara nga nxënësit, të cilat janë përfaqësuese të talentit, të hulumtimeve praktike, të punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.);

- vetëvlerësimeve të nxënësit;

- vlerësimeve të prindërve.

[1] Dokument i hartuar nga IZHA.

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III bëhet me përshkrim. Ai përbëhet nga vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i punimeve dhe i produkteve, si dhe vlerësimi i testimeve dhe detyrave të kontrollit.

Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënit realizohet me përshkrim në periudha periodike tremujore. Ai realizohet me *5 nivele të vlerësimit,* si më poshtë:

- *Niveli 1*. "*Arritje të pakënaqshme*", kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënit.

- *Niveli 2*. "*Arritje që kanë nevojë për përmirësim*", kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e mësuesit.

- *Niveli 3*. "*Arritje të kënaqshme*", kur nxënësi ka përmbushur kërkesat mesatare të të nxënit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë.

- *Niveli 4*. "*Arritje shumë të kënaqshme*", kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënit.

- *Niveli 5*. "*Arritje të shkëlqyera*", kur nxënësi përmbush plotësisht kërkesat e të nxënit të programit lëndor.

Vlerësimi kryhet sipas peshave në përqindje si më poshtë:

- Vlerësimi i vazhduar 45%, i cili përmban përgatitjen e nxënësit dhe detyrave që bën në shtëpi (15%) si dhe punëve me shkrim që kryen nxënësi në klasë dhe përgjigjet që jep me gojë (30%).

- Vlerësimi i punimeve dhe i produkteve 25%, i cili përmban punën e pavarur, bashkëpunimin me nxënësit e tjerë, pjesëmarrjen në projekte dhe veprimtari të tjera që zhvillohen në klasë, si dhe nismat e tij individuale.

- Vlerësimi i rezultateve në testime dhe në detyra kontrolli 30%.

Në fund të vitit, pas realizimit të vlerësimit të tretë përshkrues, mësuesi përmbledh përparimin vjetor të nxënësit për kompetencat e fushave të të nxënit. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit për secilën lëndë, bëhet në fund të vitit shkollor.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Shamku, Violeta
Muzika 3 : libër për mësuesin / Violeta Shamku. –
Tiranë : Pegi, 2017
96 f. : me partitura e il.; 18.2x25.4 cm.
ISBN 978-9928-248-11-4

1. Muzika 2. Libër për mësuesin 3. Tekste për shkollat
9-vjeçare

78 (076.1) (075.2)